Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Florije Rexhepi	**25.08.2023**	**05.09.2023**	**2023/0606**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 22.08.2023, OE "Pro & Co Group SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0606, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i objektit te Gjykates Themelore ne Prizren- Faza e Pare" me nr. të prokurimit: "328-23-6245-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Keshilli Gjyqesor i Kosoves.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: punë, vlera e parashikuar e kontrates: 2,500,000.00€.

Datat për fazat e ndryshme të procedurës së tenderit deri në ankesë janë si në vijim: Data e njoftimit për kontratë: 20.06.2023, data e hapjes së ofertës: 24.07.2023, data e vendimit për dhënien e kontratës: 10.08.2023, data e njoftimit të me letër standarde: 10.08.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi,
Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës,
Neni 11 Informatat Sekrete Afariste,
Neni 24 Zyrtaret e Prokurimit gjate ushtrimit te AP-se,
Neni 25 Trajnimi i Zyrtarëve të Prokurimit,
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve,
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës,
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale,
Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mos marrëveshjeve,
Neni 97, i RRPP-se,
Ligjit nr. 06/L081, për Qasje ne Dokumente Publike,
Ligjit nr. 06/L-082, për Mbrojtjen e te dhënave personale.

KRITERET PËR VLERËSIM

N/A

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

OE ankues eshte i përgjegjshëm.

OE i rekomanduar per kontrate eshte i përgjegjshëm.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Pro & Co Group SH.P.K.**

Pretendimi nr.1

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues – Këshilli Gjyqësorë i Kosovës nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, kryesisht nenin 59 të LPP-se dhe njeherit pretendon se AK-ja, nuk i ka ofruar qasje ne ofertën e OE te rekomanduar për kontrate dhe ne ofertën e dytë te renditur sipas çmimit, e cila është kualifikuar nga autoriteti kontaktues si ofertën e pasuksesshme.

Eksperti shqyrtues, sqaron se, OE ankues pas pranimit te letrës standarde te tenderuesit te pasuksesshëm, ka dorëzuar te autoriteti kontraktues kërkesën me shkrim me datën: 10.08.2023, për ti ofruar qasje ne ofertën e te rekomanduarit për kontrate dhe ofertën e dytë te renditur sipas çmimit.

AK-ja, nuk i ka ofruar qasje ne ofertat e kërkuara nga OE ankues, me arsyetimin se te njëjtit kanë dorëzuar kërkesën për sekret afarist, kërkesa me te cilat AK-ja, e ka njoftuar OE ankues.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE i rekomanduar për kontrate dhe OE i dyti me radhë sipas çmimit me kërkesat e tyre për sekret afarist pothuajse i kanë mbyllur ne tërësi ofertat e tyre, sepse të njëjtit në kërkesat e tyre kanë kërkuar që, i tërë kapaciteti teknik dhe profesional të jetë sekret afarist, po ashtu kapaciteti mbi gjendjen ekonomike dhe financiare, paramasa etj.

Eksperti shqyrtues sqaron se dispozitat e LPP-se, nuk i përcaktojnë qarte dokumentet të cilat mund të konsiderohen sekret afarist.

Mirëpo, gjatë analizimit të kërkesave të dosjes së tenderit, eksperti shqyrtues mendon se kërkesa me nr.1 e kapacitetit teknik dhe profesional: Një (1) Listë e Nënshkruar dhe vulosur emrat dhe mbiemrat e inxhiniereve

Nuk mund të konsiderohen si sekret afarist emri dhe mbiemri i pjesëtareve të stafit të kompanisë.

Poashtu lista e kontratave ku janë të renditura titujt e kontratave, nuk mund të konsiderohen sekret afarist, pastaj diploma nuk mund të konsiderohet sekret afarist dhe as CV-it e inxhiniereve.

Në vazhdim si kërkesë të dosjes së tenderit AK-ja, ka kërkuar një staf prej: 20 punëtoreve fizik, ku OE-te, janë obliguar që ti prezantojnë ne një liste me emra dhe mbiemra. Edhe sa i përket kësaj kërkese eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk ka të beje me sekret afarist.

Duke u bazuar ne sqarimet e me sipërme eksperti shqyrtues, vlerëson se ky aktivitet i prokurimit duhet te kthehet ne rivlerësim, mirëpo në ketë rast AK-ja, nuk ka të beje me rivlerësim të ofertave

sepse AK-ja, obligohet që ti jep qasje të beje një vlerësim me objektiv te dëshmive te cilat duhet ti jepen OE ankues ne mënyrë qe i njëjti ti parashtroje pretendimet e tija konform nenit 108/A te LPP-se, dhe për të njëjtat pretendime AK-ja, sipas dispozitave të nenit 108/A obligohet te jap përgjigje në pretendimet ankimore.

Prandaj, eksperti shqyrtues vlerëson se shkeljet procedurale duhet te korrigjohen dhe ne mënyrë që OE ankues, ne rast se është i interesuar sipas nenit 4.1.26 te LPP-se te parashtroje ankese ne OSHP ku i njëjti pastaj merr përgjigje ne pretendime ankimore.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet vendimi i AK-se për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Pro & Co Group SH.P.K.**

REPUBLIKA E KOSOVËS
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PRISHTINË/A
REPUBLIKA KOSOVA

Florije Rexhepi